

## **AKT THEMELIMI**

1. Me cilesine e aksionerit te Bankes se Kursimeve, cilesi te cilen e kam ne baze te nenit 1 te Dekretit 1430, date 27.03.1996 "Per transformimin e bankave shteterore ne shoqeri tregtare dhe lejimin e privatizimit te tyre", nxjerr kete akt themelimi.

2. Banka e Kursimeve, me poshte e quajtur banka, themelohet si shoqeri anonime pa oferte publike, ne baze te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ne baze te Ligjit Nr.8075, date 22.02.1996 "Per sistemin bankar ne Republiken e Shqiperise".

3. Banka e Kursimeve ka per objekt te veprimtarise se saj.

- Perfundimin e marreveshjeve bankare me banka te tjera, mbajtja e marredhenieve te korespondences me to, celja dhe mbajtja e llogarive te ndryshme prane saj si dhe depozitimi i fondeve te saj prane bankave te huaja.

- Pranimi i depozitave (ne formen e depozitave pa afat, depozitave me afat ose forma te tjera te depozitave) per te cilat paguhet ose jo interes.

- Dhenie dhe marrje kredie konforme ligjit Nr.8075 date 22.02.1996 "Per Sistemin Bankar ne Shqiperi" dhe rregulloreve te nxjerra nga Banka e Shqiperise.

- Kryerja e veprimeve te pageses.

- Administrimi i mjeteve te pageses (perfshire perdorimin e ceqeve ,etj)

- Kryerja e operacioneve te kembimeve valutore per nevoja te veta dhe te klienteve te saj, perfshire kontratat e se ardhmes per kembimet valutore.

- Emetimi ose shitja e letrave me vlere dhe blerja e aksioneve duke mbajtur parasysh kriteret e percaktuara ne Ligjin Nr.8075 date 22.02.1996 "Per sistemin Bankar ne Shqiperi" si dhe rregullat e percaktuara nga Banka e Shqiperise.

- Ruajtja dhe administrimi i titujve dhe dokumentave me vlere te te treteve. Dhenia e dorezanive, garancive si dhe instrumentave te tjere te ngjashem, duke mbajtur pergjegjesi te plote per to.

- Krijimi i Bankave te perbashketa me pjesemarrjen pjesisht te fondeve te saj, duke siguruar me pare licensen nga Banka e Shqiperise.

- Berja pronar e pasurive te paluajtshme per shkak te garantimit te kthimit te kredise ose pemirosimit te saj.

- Kujdesja per investimin e huave shteterore.
- Kryerja e veprimeve te tjera qe nuk jane ndaluar ligjesisht.

4. Banka krijohet si nje shoqeri anonime pa oferte publike per te ushtruar veprimtari per nje periudhe kohe te pacaktuar.

5. Kapitali themeltar i Bankes eshte 700.000.000 (shtateqindmilion) leke. Ai eshte i ndare ne 7.000 (shtatemije) aksione te se njejtës kategori me vlere nominale prej 100.000(njeqindmije) leke per cdo aksion.

Aksionet jane te numertuara nga 1 deri 7.000 perfshire numrin e fundit te aksionit.

6. Selia e Bankes ndodhet ne Tirane rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit" Nr.6.

7. Keshilli Drejtues i Bankes se Kursimeve si shoqeri anonime ne perputhje me ligjin Nr.8075, date 22.02.1996 "Per sistemin bankar ne Republiken e Shqiperise" perbehet si me poshte :

Lavdosha Zaho	Anetar
Artan Santo	Anetar
Everest Musta	Anetar
Illir Zeqo	Anetar
Fatmir Mema	Anetar
Gjergj Teneqexhi	Anetar
Ermira Skenderi	Anetar
Bashkim Ruseti	Anetar
Arben Ahmetaj	Anetar
Ariana Nati	Anetar

8. Banka do te ushtroje veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe ne perputhje me kete akte themelimi dhe me statutin e saj.

**AKSIONERI**

**ARBEN MALAJ**

**MINISTER I FINANCAVE**



# STATUT

## I

### **BANKES SE KURSIMEVE**

#### **KAPITULLI I**

#### **FORMA, EMERTIMI, SELIA DHE OBJEKTI**

##### Neni 1.

##### Forma juridike

Banka themelohet ne formen e shoqerise anonime pa oferte publike dhe do te funksionojë ne perputhje me dispozitat e ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", te ligjit Nr.8075 date 22.2.1996 "Per sistemin bankar ne Republiken e Shqiperise" dhe sipas ketij statuti e aktit te themelimit.

##### Neni 2

##### Emertimi

Emertimi i plote eshte "Banka e Kursimeve" Sh.A dhe emertimi i shkurtuar "B.K." Sh.A

Banka ka stemen dhe vulen zyrtare te saj.

Ne te gjitha aktet dhe dokumentet e dala nga Banka dhe te destinuara per te tretet tregohet emertimi i plote i Bankes si dhe adresa e selise te saj.

Neni 3

Selia dhe rrjeti

Selia e bankes eshte ne Tirane Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit" Nr.6 Tirane ku eshte vendosur Drejtoria e Pergjithshme e saj.

Banka ka rrjetin e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise perbere nga dege, agjensi dhe zyra bankare.

Me miratim te Bankes se Shqiperise, Banka shtrin rrjetin bankar edhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 4

Kohezgjatja

Banka themelohet per te ushtruar veprimtari ne peruthje me legjislacionin ne fuqi dhe me kete statut per nje afat kohor te pacaktuar.

Neni 5

Objekti.

Ne pajtim me licensen e leshuar nga Banka e Shqiperise, Banka e Kursimeve do te kete per objekt :

1. Perfundimin e marreveshjeve bankare me banka te tjera, mbajtja e marredhenieje te korespondences me to, çelja dhe mbajtja e llogarive te ndryshme prane saj si dhe depozitimi i fondeve te saj prane bankave te huaja.
2. Pranimi i depozitave (ne formen e depozitave pa afat, depozitave me afat ose forma te tjera te depozitave) per te cilat paguhet ose jo interes.
3. Dhenie dhe marrje kredie konforme ligjit Nr.8075 date 22.02.1996 "Per Sistemin Bankar ne Shqiperi" dhe rregulloreve te nxjerra nga Banka e Shqiperise.
4. Kryerja e veprimeve te pageses.
5. Administrimi i mjeteve te pageses(perfshire perdorimin e çeqeve, etj).

6. Kryerja e operacioneve te kembimeve valutore per nevoja te veta dhe te klienteve te saj, perfshire kontratat e se ardhmes per kembimet valutore.
7. Emetimi ose shitja e letrave me vlere dhe blerja e aksioneve duke mbajtur parasysh kriteret e percaktuara ne Ligjin Nr.8075 date 22.02.1996 "Per sistemin Bankar ne Shqiperi" si dhe rregullat e percaktuara nga Banka e Shqiperise.
8. Ruajtja dhe administrimi i titujve dhe dokumentave me vlere te te treteve.
9. Dhenia e dorezanive, garancive si dhe instrumentave te tjere te ngjashem, duke mbajtur pergjegjesi te plote per to.
10. Krijimi i Bankave te perbashketa me pjesemarrjen pjeserisht te fondeve te saj, duke siguruar me pare licensen nga Banka e Shqiperise.
11. Berja pronar e pasurive te paluajtshme per shkak te garantimit te kthimit te kredise ose permiresimit te saj.
12. Kujdesja per investimin e huave shteterore.
13. Kryerja e veprimeve te tjera qe nuk jane ndaluar ligjerisht.

## **KAPITULLI II**

### **KAPITALI THEMELTAR DHE AKSIONET**

#### Neni 6

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i bankes eshte 700.000.000 ( shtateqindmilion )leke.

Ai eshte i ndare ne 7.000 (shtatemije) aksione te se njejtës kategori me vlere nominale prej 100.000 ( njeqindmije) leke per çdo aksion.

Aksionet jane te numertuara nga 1 deri 7.000 perfshire numrin e fundit te aksionit.

## Neni 7

### Zmadhimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i bankes mund te zmadhohet sipas modaliteteve dhe menyrave te parashikuara ne nenet 150 deri 163 te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te kryhet vetem me vendim te asamblese te jashtezakonshme te aksionereve, ne baze te raportit te keshillit te drejtuesve, i cili permban treguesit e kerkuar nga ligji.

Aksioneret kane te drejten e perparesise per nenshkrimin e aksioneve te shlyeshme ne para qe emetohen per zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejte eshte perpjestimore me shumen e aksioneve te zoteruara nga secili aksioner perpara zmadhimit te kapitalit.

Aksioneret mund te heqin dore vetem individualisht nga e drejta per nenshkrimin e aksioneve te reja. Ata munden te kerkojne nenshkrimin e nje numri me te vogel aksionesh nga sa u takon sipas parimit te perpjestueshmerise, por me kusht qe asambleja te kete vendosur shprehimisht per kete.

## Neni 8

### Zvogelimi i kapitalit themeltar

Zvogelimi i kapitalit themeltar te bankes kryhet vetem me vendim te asamblese te pergjithshme te jashtezakonshme te aksionereve dhe ne pajtim me dispozitat e neneve 164 deri 166 te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

Zvogelimi i kapitalit themeltar nepermjet riblerjes te aksioneve ose te shperndarjes te mjeteve rezerve mund te vendoset vetem pasi te jete marre paraprakisht autorizimi me shkrim nga Banka e Shqiperise.

Banka nuk mund të bejë shpërndarje kapitali nëqoftesë sipas bankës së Shqipërisë, pas shpërndarjes bankës do t'i mbetet me pak se kapitali minimum i detyrueshem.

### Neni 9

#### Shlyerja e aksioneve

Aksionet për kapitalin në para të nënshkruara në zbatim të një vendimi për zmadhimin e kapitalit do të shlyhen të pakten për 50 për qind të vlerës së tyre që në momentin e nënshkrimit.

Pjesa tjetër e vlerës do të shlyhet me një ose disa keste në bazë të kerkimit për shlyerje nga Keshilli Drejtues në një afat prej 3 vjetësh nga dita kur zmadhimi i kapitalit është bërë perfundimtar.

Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme që vendos zmadhimin e kapitalit ka të drejtë të marrë një vendim për shlyerjen teresore të aksioneve që në momentin e nënshkrimit ose brenda një afati me të shkurtër nga ai i përmendur në paragrafin e dytë të këtij neni.

Kerkimi i fondeve u njoftohet nënshkruesve të pakten 15 ditë përpara datës së caktuar për çdo derdhje, me leter rekomande dhe me kthim përgjigjeje, drejtuar çdo titullari të aksioneve.

Çdo vonesë në derdhjen e shumave të kerkuara sjell pagimin e interesave sipas përqindjeve ligjore duke filluar nga data e kerkimit të çdo derdhjeje pa qenë nevoja për të proceduar në formalitete të tjera të çfaredoshme dhe pa hequr dorë nga veprimet e Bankës ndaj aksionerit detyrues dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga ligji.

### Neni 10.

#### Forma e aksioneve

Aksionet e bankës janë të formës nominative.

Pronesia e aksioneve vertetohet nga regjistrimi i tyre ne emer te pronarit ne regjistrin e mbajtur per kete qellim nga Banka, ne kushtet dhe sipas menyrove te parashikuara nga ligji.

Banka i leshon atij nje vertetim te regjistrimit te aksioneve ne pronesi te tij.

### Neni 11.

#### Shitja dhe transferimi i aksioneve

Sa kohe qe banka do te jete pa oferte publike, pervec rastit te trashegimise transferimi i pronesise mbi aksionet nje personi joaksionar, pavaresisht nga baza juridike e ketij transferimi, duhet te miratohet nga Keshilli Drejtues ne kushtet dhe sipas procedurave te parashikuara nga neni 207 i ligjit per shoqerite tregtare. Transferimi i aksioneve ne rast trashegimie sipas parashikimeve te ketij paragrafi zbatohet vetem per ato aksione, te cilat nuk jane ne pronesi te shtetit.

Neqoftese Keshilli Drejtues ka refuzuar shitjen e aksioneve nje bleresi te dhene joaksionar, brenda tete diteve nga data e njoftimit te refuzimit, shitesi duhet te njoftoje shoqerine me leter rekomande ne se ka hequr dore apo jo nga projekti i shitjes se aksioneve.

Neqoftese per vleresimin e aksioneve ka vend per ekspertize, shpenzimet per kete perballohen per gjysme nga shitesi dhe per gjysme nga bleresi.

### Neni 12

#### Pandashmeria e aksioneve

Aksionet jane te pandashme per kundrejt bankes.

Bashkepronaret e aksioneve jane te detyruar te paraqiten prane Bankes nga njeri prej tyre, i konsideruar si pronar i vetem, ose nga nje perfaqesues i vetem i zgjedhur nga bashkepronaret. Ne rast mosmarreveshje perfaqesuesi mund te caktohet nga gjykata me kerkesen e bashkepronarit qe e merr i pari kete nisme.



Neni 13

Te drejttat dhe detyrimet e lidhura me aksionet

Çdo aksion jep te drejten e pjesemarrjes ne fitimet e shperndashme vjetore te bankes dhe ne tepricen e aktivitetit te mbetur ne rastin e nje likuidimi, ne nje pjese perpjestimore me kuoten e kapitalit qe perfaqeson aksioni.  
Pervec kesaj ai jep te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne asamblete e pergjithshme ne kushtet ligjore dhe statutore.

Aksioneret jane pergjegjes per detyrimet e Bankes ndaj te treteve dhe per humbjet e saj deri ne masen e shumes nominale te aksioneve qe zoterojne.  
Çdo kerkim i fondeve pertej kesaj shume eshte i ndaluar.

Te drejttat dhe detyrimet e lidhura me aksionin e ndjekin kete aksion ne çfaredo dore qe ai kalon.

Pronesia e nje aksioni permban automatikisht te drejten e aderimit ne statutin e bankes dhe ne vendimet e asamblese se pergjithshme.

**KAPITULLI III**

**DREJTIMI, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI**

**Seksioni I**

**Keshilli Drejtues**

Neni 14.

Perberja dhe emerimi

Banka drejtohet nga nje keshill drejtuesish qe perbehet nga nje numer tek prej 5 deri 11 anetare, me rezerven e shumangieve te parashikuara nga ligji per rastet e bashkimit me nje banke tjeter.

Antaret e Keshillit Drejtues emerohen nga mbledhja e pergjithshme e zakonshme e aksionereve per nje kohe prej kater vjet. Ne emerimin e anetareve te Keshillit Drejtues respektohen papajtueshmerite apo ndalesat e percaktuara ne nenin 21 te ligjit "Per sistemin bankar ne Republiken e Shqiperise".

Funksionet e anetareve te Keshillit Drejtues perfundojne normalisht ne mbarim te mbledhjes se pergjithshme te aksionereve qe vendos per llogarite e ushtrimit te mbyllur e mbajtur ne vitin gjate te cilit mbaron mandati i tyre.

Antaret e Keshillit Drejtues jane te rizgjedhshem.

Ata mund te shkarkohen ne çdo kohe nga mbledhja e pergjithshme e zakonshme e aksionereve. Anetaret e Keshillit Drejtues lirohen nga detyra ne te gjitha rastet e parashikuara nga neni 21 i ligjit "Per sistemin Bankar ne Republiken e Shqiperise".

#### Neni 15.

#### Anetare te Keshillit Drejtues nga te punesuarit

Nje i punesuar i bankes mund te zgjidhet anetar i Keshillit Drejtues.

Parashikimi i nenit 109, te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tragtare", zbatohet me rastin e shitjes se aksioneve te bankes ne te trete jashte personave shteterore.

#### Neni 16.

#### Person juridik anetar i Keshillit Drejtues

Nje person juridik qe eshte aksioner i bankes mund te jete anetar i Keshillit Drejtues. Ne kete rast ky duhet te caktoje, qysh ne çastin e zgjedhjes, nje perfaqesues te perhershem person fizik, i cili u nenshtrohet te njejtave kushte dhe detyrimeve dhe ka te njejtat pergjegjesi civile e penale sikur te ishte ai vete anetar i keshillit, duke mos perjashtuar nga pergjegjesia e perbashket personin juridik qe ai perfaqeson.

Neqoftese, personi juridik ia heq mandatin perfaqesuesit te tij duhet te njoftoje per kete banken menjehere dhe te beje njekohesisht zevendesimin e

tij. Ky rregull do te zbatohet edhe ne rastet e vdekjes, te doreheqjes ose te pengimeve te zgjatura te perfaqesuesit te perhershem.

### Neni 17.

#### Vendet bosh ne Keshillin Drejtues

Neqoftese nje ose disa vende ne Keshillin Drejtues mbeten bosh midis dy mbledhjeve te pergjithshme te aksionereve, si rrjedhoje e vdekjes apo doreheqjes, keshilli mund te beje nje ose disa emerime te perkoheshme, per aq kohe sa banka eshte ne pronesi te shtetit te drejten e berjes se zevendesimeve ne Keshillin Drejtues e ka personi, i cili ushtron te drejten e pronesise ne emer te shtetit.

Emerimi i anetareve nga vete keshilli duhet te ratifikohet nga mbledhja e pergjithshme me e afert e aksionereve. Ne rastin kur mbledhja e pergjithshme e aksionereve nuk ratifikon anetaret e emeruar nga keshilli vendimet e marra me pare nga keshilli mbeten gjithmone te vlefshme.

Kur numri i anetareve te Keshillit Drejtues ne funksion ka zbritur nen pese, keshilli duhet te therrase urgjentisht mbledhjen e zakonshme te asamblese per te plotesuar efektivin e keshillit.

### Neni 18.

#### Aksionet e anetareve te Keshillit Drejtues

Anetaret e Keshillit Drejtues duhet te jene secili pronar te pakten i nje aksioni te bankes te quajtura keto aksione te funksioneve.

Anetaret e Keshillit Drejtues qe nuk zoterojne aksione ne kohen e emerimit, duhet t'i blejne ato brenda tre muajve; ne te kunderten ata konsiderohen te shkarkuar.

Parashikimet e ketij neni nuk zbatohen per aq kohe sa banka eshte ne pronesi te plote te shtetit dhe per aq kohe per ata anetare te keshillave drejtuese qe emerohen nga shteti me cilesine e pronarit.

## Neni 19.

### Kryetari dhe zëvendeskryetari i keshillit

Kryetari i Keshillit Drejtues emerohet nga Keshilli Drejtues ndërmjet anëtarëve të tij. Keshilli Drejtues emeron midis anëtarëve të tij një ose dy zëvendeskryetare, të cilët nuk kanë asnjë kompetencë tjetër përveçse drejtimin e mbledhjeve të keshillit në mungesë të kryetarit.

Kryetari dhe zëvendeskryetaret e Keshillit Drejtues janë detyrimisht persona fizike.

Ata i ushtrojnë funksionet e tyre gjatë tërë periudhës së mandatit si anëtarë të Keshillit Drejtues.

Keshilli Drejtues mund të emerojë, gjithashtu, një sekretar qoftë edhe jashtë anëtarëve të tij, duke caktuar edhe kohezgjatjen e funksioneve të tij.

Kryetari i Keshillit Drejtues, zëvendeskryetari ose zëvendeskryetaret dhe sekretari janë të rizgjedhshëm.

## Neni 20.

### Mbledhjet e Keshillit Drejtues

Keshilli Drejtues është organ kolegjal; përgjegjës, vendim marrës dhe mbikeqyres për bankën. Ai bën shqyrtim dhe merr vendime vetëm nëpërmjet mbledhjeve të tij.

Keshilli Drejtues mbledhet një herë në muaj dhe sa herë që e kërkon interesi i bankës. Ai mbledhet gjithashtu në fund të çdo tremujori për të degjuar raportin e drejtorit të përgjithshëm.

Mbledhjet e Keshillit Drejtues thirren nga kryetari dhe, në mungesë të tij, nga zëvendeskryetari.

Kryetari dhe, në mungesë të tij, zëvendeskryetari duhet të thërresë mbledhjen e keshillit brenda 15 ditësh kur një e treta e anëtarëve të keshillit i paraqitin atij një kërkesë të arsyetuar për këtë. Nëqoftesë kërkesës nuk i jepet rruge

autoret e saj mund te procedojne vete ne thirrjen e mbledhjes te Keshillit Drejtues duke treguar rendin e dites te mbledhjes.

Mbledhjet e Keshillit Drejtues mbahen ne seline e Bankes ose ne nje vend tjetër te treguar ne thirrje.

Si rregull thirrja e mbledhjes duhet t'u dergohet anetareve te keshillit tre dite perpara me leter, telegram ose telex.

Çdo thirrje duhet te permbaje çeshtjet kryesore te rendit te dites.

Mbledhjet e Keshillit Drejtues drejtohen nga kryetari dhe, ne mungese te tij, nga zevendeskryetari. Ne rastet kur keta mungojne te dy, keshilli zgjedh midis anetareve te pranishem kryetarin e seances.

#### Neni 21.

#### Vendimet e Keshillit Drejtues

Keshilli Drejtues merr vendime te vlefshme kur ne mbledhjen e tij jane te pranishem me shume se gjysma e anetareve ne funksion.

Çdo anetar i keshillit mund t'i jape mandat nje anetari tjetër per ta perfaqesuar ne mbledhjen e keshillit. Çdo anetar mund te jape vetem nje mandat per te njejten mbledhje. Anetari i perfaqesuar nuk merret parasysh ne llogaritjen e quorumit te anetareve te pranishem, siç percaktohet ne paragrafin e pare.

Vendimet merren me shumicen e votave te anetareve te pranishem ose te perfaqesuar. Çdo anetar i keshillit ka vetem nje vote dhe nuk mund te perfaqesoje me shume se nje anetar tjetër.

Megjithate kur Keshilli Drejtues eshte mbledhur per te vendosur mbi nje projekt te shitjes se aksioneve nje te treti joaksionar ne kushtet e parashikuara ne nenin 11 te ketij statuti, vendimi i miratimit merret me shumicen e tre te katertave te votave te anetareve te pranishem ose te perfaqesuar. Neqoftese shitesi i aksioneve eshte anetar i Keshillit Drejtues ai nuk merr pjese ne votim.

Ne rast votash te barabarta ajo e kryetarit te seances eshte percaktuese.

## Neni 22

### Dokumentimi i mbledhjeve dhe i vendimeve

Keshilli Drejtues mban nje liber te pranise, i cili firmoset nga anetaret pjesemarrres ne mbledhje.

Justifikimi i numrit te anetareve ne funksion dhe i emerimit te tyre provohet ne menyre te vlefshme ndaj te treteve vetem nga tregimi ne procesverbalin e çdo mbledhje te emrave te anetareve te pranishem, te perfaqesuar ose te munguar.

Shqyrtimet dhe vendimet e Keshillit Drejtues evidentohen me ane te procesverbaleve te mbajtura ne nje liber te posacem (protokoll), i numertuar dhe i vulosur, qe mbahet ne drejtorine qendrore te bankes ne te cilin tregohen, veç te tjerash, anetaret e pranishem, te perfaqesuar dhe te munguar si dhe çdo person tjetër qe ka asistuar ne mbledhjen e keshillit, teresisht ose pjeserisht.

Procesverbalet firmosen nga kryetari i seances dhe te pakten nga nje anetar i keshillit.

## Neni 23.

### Kompetencat e Keshillit Drejtues

Keshilli Drejtues i bankes eshte pergjegjes per hartimin e politikave dhe mbikqyrjen e veprimtarise se bankes.

Me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe ky statut ia kane rezervuar asamblese se pergjithshme te aksionereve keshilli i drejtuesve ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te bankes dhe per te kryer ose autorizuar kryerjen e çdo operacioni qe eshte brenda objektit te bankes.

Aktet dhe operacionet e renditura me poshte jane ne kompetence vetem te Keshillit Drejtues:

1. Miratimi i rregulloreve te brendshme te bankes qe percaktojne:

a) struktura e organizimit dhe të administrimit të bankes, duke përfshirë edhe njësitet funksionale dhe administrative të saj, pozicionet mbikqyrese dhe marrëdhëniet raportuese.

b) detyrat e çdo drejtori departamenti dhe të njësive që ai drejton e mbikqyr.

c) kufijte e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm dhe të punonjësve të tjerë të bankes që kryejnë operacione financiare në emer dhe për llogari të saj.

d) funksionet e komitetit të kontrollit të brendshëm dhe të komiteteve të tjera të brendshme të ngritura nga Këshilli Drejtues.

2. Miratimi dhe mbikqyrja e zbatimit të politikës bankare për :

a) Llojet, kushtet dhe afatet e pranimit të depozitave.

b) Llojet, kushtet dhe afatet e dhenies së kredive nga ana e bankes.

c) Kushtet e përqindjes të interesit vjetor që lidhen me depozitat dhe dhenien e kredise, ndryshimet e tyre duke përfshirë edhe menyrën e llogaritjes.

d) Kushtet dhe kriteret sipas të cilave Banka mund të negociojë me institucione financiare të tjera, vendas apo të huaja, për të marrë hua si dhe kufijte e huamarrjes.

e) Llojet, kushtet, afatet dhe shumat e instrumenteve të borxhit që mund të emtohen dhe shiten nga banka.

f) Llojet e pasurive në të cilat banka mund të investojë, si dhe shpërndarjen e këtyre investimeve me qëllim që të sigurohet menjëherë i rreziqeve, ruajtja e vlerës dhe tregueshmeria me lehtësi e tyre.

g) Zgjerimin e veprimtarisë së bankes me produkte të reja brenda kufijve të caktuar në licencën e leshuar nga Banka e Shqipërisë.

3. Miratimi i numrit te pergjithshem te personelit te bankes, i kriterëve te marrjes ne pune te personelit teknik, i tabelave te pagave dhe i kriterëve per dhenien e shperblimeve suplementare.

4. Miratimi i zgjerimit te bankes dhe i bashkimit apo i mbylljes te degeve apo agjensive te saj.

5. Miratimi me vendim te kredive qe banka u jep personave te lidhur me te, siç jane percaktuar keto ne nenin 35 te ligjit "Per sistemin bankar ne Republiken e Shqiperise dhe sipas kushteve te percaktuara" ne nenin 38 te po ketij ligji.

6. Pergatitja dhe paraqitja per shqyrtim ne mbledhjen e pergjithshme te aksionereve te gjendjeve financiare vjetore dhe te raportit te veprimtarise.

7. Thirrja e asamblese se pergjithshme sa here qe kjo eshte e nevojshme dhe ne mbyllje te çdo viti financiar per te miratuar gjendjet financiare vjetore.

## Neni 24

### Informimi i anetareve te keshillit

Çdo anetar i Keshillit Drejtues ka te drejte te kerkoje dhe te marre nga Drejtoria e Pergjithshme e Bankes informacion per çeshtje te natyres administrative; teknike dhe financiare qe i mundesojne atij te verifikojë dhe gjykoje per kushtet ne te cilat zhvillohet veprimtaria e bankes dhe te jete plotesisht i qarte per vendimet qe duhen marre apo qe do te merren nga ana e keshillit.

Kryetari i Keshillit Drejtues ka pergjegjesine per t'i vene anetaret e keshillit ne gjendje qe te marrin informacionet e kerkuara.

Çdo anetar i Keshillit Drejtues duhet te njoftohet personalisht per mbledhjet e keshillit dhe t'i vihen ne dispozicion ne seline e bankes apo t'i dergohen bashke me thirrjen dokumentet dhe raportet qe do te shqyrtohen ne mbledhje.



Banka nuk eshte e detyruar ti jape anetareve te Keshillit Drejtues kopjo te proces verbaleve te vendimeve te keshillit, por çdo anetar mund te kerkoje qe te njihet me to ne seline e bankes.

Mosnjohja e te drejtave te çdo anetari te keshillit per informacionet e mesiperme dhe mos thirrja ne mbledhjen e keshillit sjell pavlefshmerine e vendimeve te keshillit.

#### Neni 25.

#### Pergjegjesite e anetareve te Keshillit Drejtues

Anetaret e Keshillit Drejtues mbajne pergjegjesi civile solidarisht dhe individualisht, sipas rastit, ndaj te treteve dhe ndaj shoqerise per shkeljet e dispozitave ligjore ose te rregullimeve te zbatueshme per banken, per shkelje te statutit si dhe per gabimet e bera ne administrimin e bankes.

Pergjegjësia penale e anetareve te Keshillit Drejtues percaktohet ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi.

#### Neni 26.

#### Shperblimi i vecante per pjesemarrjen ne keshill dhe shperblimet e jashtezakonshme

Asambleja e pergjithshme e zakonshme mund t'u caktojë anetareve te Keshillit Drejtues si shperblim per pjesemarrjen ne keshill nje shume vjetore fikse, e cila mbetet e pandryshuar deri ne nje vendim te kundert te asamblese.

Shuma e shperblimit te caktuar per keshillin shperndahet midis anetareve te tij nga vete keshilli i drejtuesve.

Keshilli Drejtues mund te caktojë shperblime te jashtezakonshme per anetaret te cileve u ngarkohen misione apo u jepen mandate per sherbime apo detyra te caktuara.

Shperblimet e veçanta dhe te jashtezakonshme perballohen nga llogaria e bankes dhe kalohen ne shpenzimet e saj.

Perveç shperblimeve te permendura ne kete nen dhe shperblimeve qe rrjedhin nga nje kontrate punesimi me banken ne kushtet e parashikuara nga ligji, anetareve te Keshillit Drejtues nuk u caktohet asnje shperblim tjeter i perhershem ose jo.

## **Seksioni 2**

### **Drejtori i pergjithshem, ndihmesdrejtori i pergjithshem dhe drejtoret teknike**

#### **Neni 27.**

##### **Drejtori i pergjithshem**

Drejtori i Pergjithshem i bankes emerohet nga Ministri i Financave, per aq kohe sa ky i fundit ushtron te drejten e pronesise ne emer te shtetit.

Drejtori i Pergjithshem i Bankes konsiderohet i punesuar i bankes. Largimi i tij nga detyra behet ne perputhje me parashikimet e nenit 98 te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

Drejtori i pergjithshem perfaqeson banken ne marrredheniet me te tretet me kompetenca te plota ne kufijte e objektit te saj, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia ka caktuar shprehimisht asamblese se pergjithshme te aksionereve dhe te kompetencave te specifikuara te Keshillit Drejtues.

Çdo kufizim i kompetencave te drejtorit te pergjithshem me vendim te Keshillit Drejtues eshte pa efekt ndaj te treteve.

Drejtori i pergjithshem mund t'i delegeje nje pjese te kompetencave te tij tek persona te tjere, anetare te Keshillit Drejtues ose te punesuar te bankes.

Neni 28.

Nendretoret e pergjithshem

Ministri i Financave per aq kohe sa ushtron te drejten e pronesise ne emer te shtetit per banken, ka te drejten e emrimit te dy nendretoreve te pergjithshem te bankes. Nendretoret e bankes jane te punesuar te bankes. Njeri nga nendretoret e bankes duhet te jete anetar i Keshillit drejtues te bankes. Parashkimet e nenti 98 te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" zbatohen edhe per largimin e nendretoreve nga puna.

Neqoftese emerohen dy ndihmesdrejtor te pergjithshem njeri prej tyre mund te mos te jete anetar i Keshillit Drejtues.

Shtirirja dhe kohezgjatja e kompetencave te ndihmesdrejtoreve te pergjithshem percaktohen nga Keshilli Drejtues ne marreveshje me drejtorin e pergjithshem.

Neni 29.

Zevendesimi i perkoheshem i drejtorit te pergjithshem

Keshilli Drejtues cakton ndihmesdrejtorin e pergjithshem, anetar i keshillit, qe te zevendesoje perkohesisht ne te gjitha funksionet kryetarin e keshillit-drejtor i pergjithshem ne rastet kur ky i fundit:

1. per aresye semundje te zgjatur ose nje ngjarje tjeter te papritur pengohet per te ushtruar funksionet e tij.
2. jep doreheqjen ose vdes dhe nuk eshte e mundur te behet menjehere emerimi i kryetarit te ri.

Neni 30.

Drejtoret teknike

Drejtoret teknike janë të punësuar të bankës dhe emërohen nga drejtori i përgjithshëm, i cili përcakton edhe funksionet e tyre, në pajtim me rregulloren e bankës të miratuar nga Këshilli Drejtues.

Drejtoret teknike nuk kanë asnjë kompetencë për të angazhuar bankën ndaj të tjerëve, përveç rastit kur drejtori i përgjithshëm u ka deleguar atyre me mandat një pjesë të kompetencave të tij.

**Seksioni 3**

**Komiteti i kontrollit**

Neni 31.

Perberja dhe emertimi

Komiteti i kontrollit përbëhet nga tre anëtarë, persona fizikë, aksionerë të bankës por jashtë anëtarëve të Këshillit Drejtues, dhe jashtë të punësuarve të bankës.

Anëtarët e komitetit të kontrollit zgjidhen nga mbledhja e përgjithshme e zakonshme e aksionerëve për një periudhë kohe prej katër vjetësh. Ata janë të rizgjedhshëm.

Kryetari i komitetit të kontrollit caktohet nga mbledhja e përgjithshme e aksionerëve.

Neni 32.

Funksionet e komitetit të kontrollit

Komiteti i kontrollit të brendshëm mbikëqyr zbatimin e përpikë të ligjit dhe të statutit, verifikon inventaret dhe llogaritë vjetore të bankës.

Ai percakton dhe mbikeqyr procedurat llogaritese te bankes, kontrollon zbatimin e rregullave dhe jep mendimet e veta per çdo problem qe i kerkohet nga Keshilli Drejtues.

Komiteti i kontrollit merr pjese ne mbledhjet e Keshillit Drejtues dhe i paraqet mbledhjes se pergjithshme vjetore te aksionereve verejtjet e tij.

Me kerkesen e tij komiteti i kontrollit te brendshem mund te ndihmohet ne punen e tij nga eksperte te tjere qe caktohen nga Keshilli Drejtues te bankes.

### Neni 33.

#### Mbledhjet dhe vendimet

Komiteti i kontrollit mblidhet jo me pak se nje here ne tre muaj. Keshilli i Drejtues mund te kerkoje sa here qe e çmon te nevojshme mbledhjen e jashtezakonshme te ketij komiteti.

Komiteti i kontrollit merr vendime te vlefshme kur jane te pranishem te pakten dy anetare te tij.

Vendimet merren me shumicen e votave kur jane te pranishem te gjithe anetaret e tij dhe me unanimitet kur jane te pranishem vetem dy anetare. Abstenime nuk lejohen.

### Neni 34.

#### Shperblimi i anetareve te komitetit te kontrollit

Asambleja e pergjithshme e zakonshme mund t'u caktoje anetareve te komitetit te kontrollit si shperblim nje shume vjetore fikse e cila mbetet e pandryshuar deri ne nje vendim te kundert te asamblese.

Anetaret e komitetit te kontrollit kane te drejten e rimbursimit te shpenzimeve per sherbimet e kryera ne interes te kontrollit, kundrejt paraqitjes te dokumenteve justifikuese.

#### **Seksioni 4**

#### **Dispozita te perbashketa per administratoret**

##### **Neni 35.**

##### **Marreveshjet qe kerkojne autorizim**

Çdo marreveshje midis bankes dhe personave te lidhur ne te, siç jane percaktuar keta persona ne nenin 35 te ligjit "Per sistemin bankar ne Republiken e Shqiperise", kerkon autorizim paraprak te Keshillit Drejtues te bankes.

Keshilli i drejtuesve merr vendim ne kushtet dhe sipas menyrave te parashikuara nga neni 38 i ligjit te cituar me siper, por duke respektuar kerkesat e nenit 37 te po ketij ligji.

##### **Neni 36.**

##### **Kontrolli mbi marreveshjet, kundershmtueshmeria dhe pavlefshmeria**

Per kontrollin e marreveshjeve qe kerkojne autorizimin paraprak te Keshillit Drejtues, per miratimin apo kundershmtimin e tyre nga asambleja e pergjithshme si dhe per pavlefshmerine e marreveshjes zbatohen dispozitat e neneve 123, 124 dhe 125 te ligjit "Per shoqerite tregtare".

##### **Neni 37.**

##### **Deklarimi i konflikteve te interesave**

Te gjithe personat qe sipas ligjit "Per sistemin bankar ne Republiken e Shqiperise" kane cilesine e administratorit duhet te deklarojne me shkrim ne Keshillin Drejtues te bankes natyren dhe shkallen e interesit ose te maredhenieve me perfitim material per rastet dhe sipas formes te kerkuar nga neni 25 i po ketij ligji.

Deklarimi i konflikteve te interesave dhe i atyre me perfitim material behet here pas here, por jo me rralle se nje here ne vit.

Keshilli Drejtues i bankes mund te nxjerre nje rregullim te brendshem per kete deklarim.

### Neni 38.

#### Detyrimi per te ruajtur sekretin

Anetaret e Keshillit Drejtues dhe te komitetit te kontrollit, nepunesit e bankes dhe agjente te saj, jane te detyruar te ruajne fshehtesine e çdo informacioni qe marrin gjate kryerjes se detyrave ne banke dhe te mos e perdorin ate per perfitime personale apo per te trete, si gjate kohes qe jane ne funksion ashtu edhe pas largimit te tyre.

Ky detyrim shtrihet, gjithashtu, mbi çdo person tjetër qe per shkak te detyres merr informacion per banken.

Keshilli Drejtues i bankes miraton rregulla e procedura me te hollesishme lidhur me ruajtjen e sekretit nga personat e permendur me siper si dhe per komunikimin e informacioneve autoriteteve apo organeve te cileve kjo e drejte u eshte njohur me ligj.

### **Seksioni 5** **Kontrollori i pavarur** **(Eksperti kontabel i Autorizuar)**

### Neni 39

#### Emerimi dhe shperblimi

Asambleja e pergjithshme e aksionereve, pasi te jete marre miratimi i Bankes se Shqiperise, cakton nje kontrollor te pavarur dhe nje ndihmes te tij, te zgjedhur te dy nga lista e Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar.

Ne caktimin e kontrolloreve te pavarur mbahen parasysht perjashtimet dhe papajtuesmerite e percaktuara nga ligji "Per shoqerite tregtare".

Kontrolloret e pavarur caktohen per nje kohe qe i pergjigjet nje ushtrimi financiar.

Ata jane te ricaktueshem.

Shperblimi i kontrolloreve te pavarur caktohet nga asambleja e aksioneve dhe perballohet nga banka.

#### Neni 40

##### Detyrat dhe te drejtat

Detyrat dhe te drejtat e kontrolloreve te pavarur te bankes jane ato te parashikuara nga ligji "Per shoqerite tregtare" dhe nga ligji "Per sistemin bankar ne Republiken e Shqiperise".

Asambleja e aksionereve mund t'u kerkoje kontrolloreve te pavarur kryerjen e kontrolleve apo verifikimeve te posacme per çeshtje ne interes te bankes.

## **KAPITULLI IV**

### **ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE**

#### Neni 41

##### Natyra e asambleve dhe karakteri detyrues i vendimeve

Asamblete e pergjithshme te aksionereve cilesohen asamble te zakonshme ose te jashtezakonshme sipas natyres se vendimeve qe ato jane thirrur per te marre.

Çdo asamble e pergjithshme e mbledhur rregullisht perfaqeson teresine e aksionareve me te drejte vote.



Vendimet e asamblese se pergjithshme detyrojne te gjithë aksionaret madje edhe ata qe mungojne ne mbledhje apo qe votojne kunder.

#### Neni 42.

##### Thirrja dhe vendi i asamblese.

Asamblete e pergjithshme thirren nga Keshilli Drejtues. Ato mund te thirren, gjithashtu, nga kontrollori i pavarur ne rast urgjence, nga nje mandatmbajtes i caktuar nga gjykata dhe, kur eshte rasti, nga likuiduesi.

Asamblete e pergjithshme mbledhen ne seline e Bankes ose ne cdo vend tjetër te treguar ne thirrje.

Thirrja e asamblese se aksionareve behet me ane te njoftimit qe i dergohet cdo aksioneri ne adresen e tij me leter rekomande.

Njoftimi duhet te bjere ne doren e aksionareve apo te njihet prej tyre 15 dite perpara mbledhjes se asamblese dhe duhet te permbaje diten, oren dhe vendin e mbledhjes, natyren e asamblese, dhe rendin e dites.

Kur asambleja e mbledhur nuk ka mundur te marre vendim per shkak se nuk eshte siguruar quorumi i kerkuar, mbledhja e dyte thirret jo me vone se nje muaj nga data e thirrjes se pare, ne te njejtat forma si e para. Njoftimi ose letrat e thirrjes te mbledhjes se dyte rikujtojne daten dhe rendin e dites.

#### Neni 43

##### Rendi i dites

Rendi i dites te mbledhjes se asamblese percaktohet nga autori i thirrjes. Nje ose disa aksionare qe perfaqesojne te pakten 5 per qind te kapitalit themeltar te bankes kane te drejte te kerkojue qe te futen ne rendin e dites nje apo disa projektrezoluta.

Keto projektrezoluta dergohen ne seline e bankes te shoqeruara me nje kerkese ne te cilen tregohen edhe aresyet, si dhe me nje dokument qe provon zoterimin e pjeses te kapitalit themeltar te kerkuar nga paragrafi i dyte i ketij neni.

Projektrezolutat dhe dokumentet shoqeruese duhet te mbrijne ne seline e bankes te pakten 5 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese.

Asambleja e aksionereve nuk mund te marre ne shqyrtim nje ceshtje qe nuk eshte perfshire ne rendin e dites. Megjithate ajo mundet, ne cdo rrethane, te shkarkoje nje ose disa anetare te Keshillit Drejtues apo te komitetit te kontrollit dhe te beje zevendesimin e tyre.

Rendi i dites te mbledhjes se asamblese nuk mund te ndryshohet me nje njoftim te dyte.

#### Neni 44.

##### Hyrja ne asamble

Çdo aksioner, pavaresisht nga numri i aksioneve qe zoteron, ka te drejte te asistojte ne mbledhjet e asambleve te pergjithshme dhe te marre pjese ne vendimet e saj, personalisht apo nepermjet nje perfaqesuesi. Hyrja ne mbledhjet e asambleve te pergjithshme behet ne baze te nje dokumenti qe provon identitetin e aksionerit si dhe te rregjistrimit te tij ne regjistrin e aksioneve te bankes.

Çdo aksioner mund te perfaqesohet ne mbledhjet e asamblese vetem nga bashkeshorti ose nga nje aksioner tjetër. Per kete qellim, perfaqesuesi duhet te pajiset nga aksioneri me mandat te posacem, ne kushtet e parashikuara nga ligji.

#### Neni 45.

##### Evidenca e pjesemarrjes, drejtimi i mbledhjes dhe proces verbalet

Per çdo mbledhje te asamblese mbahet nje flete-pranie, e cila permban treguesit qe provojne identitetin e aksionerit dhe aksionet e zoteruara prej tij. Flete-prania firmoset ne ane nga aksioneri ose, kur eshte rasti, nga perfaqesuesi i tij dhe vertetohet per saktesine e saj nga komisioni vezhgues i mbledhjes.

Mbledhjet e asamblese drejtohen nga kryetari i Keshillit Drejtues dhe, ne mungese te tij, nga zevendeskryetari apo nje anetar i keshillit i caktuar posacerisht per kete qellim. Ne rastet kur thirrja e mbledhjes eshte bere nga kontrollori i pavarur, mandatmbajtesi i caktuar nga gjykata apo, likuiduesi, mbledhja drejtohet nga autori i thirrjes.

Funksionet e vezhgimit te mbledhjes kryhen nga dy aksionere te pranishem te cilet vete ose si perfaqesues, zoterojne nje numer votash me te madh se aksioneret e tjere. Vezhguesit caktojne nje sekretar, i cili mund te mos jete aksioner.

Komisioni i vezhgimit, i formuar ne kete menyre, ka per detyre te verifikoje, vertetoje dhe nenshkruaje flete-pranine, te mbikqyre zhvillimin e debateve, te kontrolloje votimet e kryera dhe te siguroje rregullaritetin e tyre si dhe te mbikqyre mbajtjen e procesverbalit te mbledhjes.

Per çdo mbledhje te asamblese hartohet nje proces verbal i cili permban:

- daten dhe vendin e mbledhjes
- menyren e thirrjes
- rendin e dites
- drejtuesi i mbledhjes dhe komisioni i vezhgimit
- numri i aksioneve qe marrin pjese ne votim
- quorumi i arritur
- permendjen e dokumenteve dhe te raporteve qe jane shtruar ne mbledhje
- nje permbledhje te debateve
- tekstet e projektrezolutave te vena ne votim, ato te miratuara dhe ato te hedhura poshte nga aksioneret.
- rezultatet e votimeve
- te miratuara

Proces verbalet e mbledhjes te asamblese hartohen ne nje regjister te posacem, i numertuar dhe i vulosur, i cili ruhet ne seline e bankes.

#### Neni 46.

##### Quorumi, votimi, numri i votave

Ne asamblete e pergjithshme, te zakonshme dhe te jashtezakonshme, quorumi llogaritet per teresine e aksioneve qe perbejne kapitalin themeltar te bankes.

E drejta e votes qe u perket aksioneve eshte perpjestimore me kapitalin qe ato perfaqesojne.

Çdo aksion i kapitalit i jep zoteruesit te pakten te drejten e nje vote. Megjithate kur aksionet e bankes zoterohen nga nje ose disa persona juridike ne te cilet banka ka, drejteperdrejte ose terthorazi, kontrollin e drejta e votes te aksioneve te personave juridike nuk mund te jete me shume se 10 per qind te votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

Votimi kryhet me doren ngritur, me thirrje emerore ose i fshehte sipas vendimit te komisionit te vezhgimit dhe drejtuesit te mbledhjes se asamblese.

Votimi kryhet e vecante per çdo çeshtje apo vendim.

#### Neni 47.

##### Asamblete e pergjithshme te zakonshme

Asambleja e pergjithshme e zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve te vitit pasardhes, per te vendosur mbi llogarite e bankes per ushtrimin financiar te mbyllur.

Ajo ka, midis te tjerash, kompetencat qe vijojne:

- te miratoje strategjine e zhvillimit afatgjate te bankes
- te miratoje plan-biznesin dhe planin financiar vjetor.
- te miratoje, ndryshoje ose te hedhe poshte llogarite vjetore qe i shtruar per miratim;

- te vendose per shperndarjen dhe destinimin e rezultatit ne pajtim me dispozitat ligjore dhe me statutin.
- te emeroje dhe shkarkoje anetaret e Keshillit Drejtues dhe te komitetit te kontrollit
- te emeroje kontrollorin ose kontrolloret e pavarur te llogarive (Ekspertet Kontabel te Autorizuar).
- te miratoje ose te mos miratoje emerimet e anetareve te Keshillit Drejtues te kryera nga vete keshilli si emerime te perkohshme.
- te miratoje pagen e drejtorit te pergjithshem dhe raportet e pagave per kategorite e tjera te personelit te bankes si dhe shperblimet suplementare qe mund te jepen per pune ose rezultate te mira.
- te caktoj shperblimin e vecante dhe shperblime te tjera te parashikuara ne kete statut per Keshillin Drejtues dhe komitetin e kontrollit
- te vendose per raportin e kontrollorit te pavarur lidhur me marreveshjet qe i nenshtrohen autorizimit paraprak te Keshillit Drejtues.

Asambleja e zakonshme merr çdo vendim qe nuk sjell ndryshime te statudit.

Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne jo me pak se 50 per qind te aksioneve me te drejte vote. Ne rast se mbledhja e pare nuk realizohet per mbledhjen e dyte nuk kerkohej asnje lloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem apo te perfaqesuar.

#### Neni 48.

#### Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mbledhet sa here qe duhet te merret nje vendim qe sjell ndryshime te ketij statuti.

Ajo nuk mund te shtojte detyrimet e aksionereve pervec operacioneve qe rrjedhin nga rigrupimi i aksioneve i kryer rregullisht.

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te

perfaqesuar zoterojne te pakten 3/4 e aksioneve me te drejte vote. Per mbledhjen e dyte ky qorum eshte jo me pak se 1/2 e aksioneve me te drejte vote.

Vendimet e asamblese se jashtezakonshme merren me shumicen prej 3/4 te votave qe u perkasin aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar.

#### Neni 49.

#### Venia ne dispozicion te aksionereve te dokumenteve dhe informacioneve

Banka mban dhe ve ne dispozicion te aksionereve, ne kushtet dhe ne afatet e parashikuara nga ligji, raportet, dokumentet dhe llogarite vjetore qe shqyrton asambleja.

Me perjashtim te inventareve dhe te ndonje dokumenti tjeter te caktuar nga asambleja, dokumentet qe duhet t'u vihen ne dispozicion aksionereve u dergohen ketyre bashke me njoftim-thirrjen per mbledhje.

## **KAPITULLI V KONTABILITETI, GJENDJET FINANCIARE, CAKTIMI I REZULTATIT**

#### Neni 50.

#### Kontabiliteti, inventari, gjendjet financiare

Banka mban kontabilitetin e saj ne pajtim me kerkesat e ligjit "Per kontabilitetin" dhe me rregullimet kontabel specifike per bankat.

Ajo kryen nje here ne 12 muaj inventarizimin e aktiveve dhe te pasiveve te saj, perpara se te pergatite gjendjet financiare vjetore.

Ne mbyllje te cdo viti financiar, por jo me vone se 3 muaj nga data e mbylljes se vitit, banka pergatit gjendjet financiare vjetore sipas rregullave te caktuara per kete qellim ne rregullimet kontabel per bankat.

Gjendjet financiare te bankes, pas miratimit nga asambleja e pergjithshme e aksionereve publikohen ne pajtim me kerkesat e ligjit "Per sistemin bankar ne Republiken e Shqiperise".

Viti financiar per te cilin perгатiten dhe publikohen gjendjet financiare te bankes fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.

### Neni 51.

#### Rezultati financiar

Rezultati financiar i bankes percaktohet ne mbyllje te cdo viti si diference midis te ardhurave dhe shpenzimeve, pasi te zbriten, gjithashtu, amortizimet dhe shumat e provizioneve per zhvleresime dhe per rreziqe e shpenzime, perjashtuar shumat e provizioneve per rreziqe bankare te pergjithshme.

Fitimi neto i bankes percaktohet pasi te zbritet tatimi mbi fitimin i llogaritur ne menyre te perqendruar per banken ne teresi.

### Neni 52

#### Caktimi(ndarja) e fitimit neto.

Fitimi neto i bankes caktohet per qellimet qe vijojne :

1. Per fondin per rreziqe bankare te pergjithshme.
2. Per rezerven e domosdoshme te parashikuar nga neni 2,3 i ligjit "Per shoqerite tregtare"
3. Per rezervat e detyrueshme te tjera te kapitaleve te veta
4. Per dividente.

Asambleja e pergjithshme mund te vendose heqjen e nje pjese te fitimeve per krijimin e rezervave te lira per t'u perdorur ne interes te zhvillimit te bankes.

Fitimet e bankes nuk mund te caktohen per shperblime apo perfitime te tjera te personelit, per sponsorizime apo dhurime dhe as per ndonje qellim tjetër qe ka natyre shpenzimi dhe hyn ne koston e aktivitetit te bankes.

### Neni 53.

#### Fitimi i shperndashem-Dividendet

Fitimi i shperndashem si dividend perbehet nga fitimi neto i vitit financiar i pakesuar me humbjet e mbartura dhe me shumat e hequra per rezervat ne zbatim te ligjit dhe te statutit dhe i shtuar nga fitimet e mbartura.

Fitimi i shperndashem ndahet midis te gjithe aksionereve ne perpjestim me numrin e aksioneve qe zoteron secili prej tyre.

Banka nuk mund te shperndaje dividente, neqoftese kapitalet e veta jane ose do te beheshin, si rrjedhoje e shperndarjes, me te vogla nga shumata e kerkuar nga ligji.

### Neni 54.

#### Humbjet dhe mbartja e tyre

Pas miratimit te gjendjeve financiare vjetore nga asambleja e pergjithshme, humbja e rezultuar ne nje vit financiar mbartet ne vitet pasues per t'u mbuluar nga fitimet e ardhshme deri ne shuarjen e humbjes.

## **KAPITULLI VI**

## **DEGET E BANKES**



### Neni 55

#### Statusi i deges

Dega e Bankes eshte njesia baze organizative e Bankes dhe varet nga Drejtoria e Pergjithshme.

Dega e Bankes krijohet ne baze rrethi ose rajoni dhe ka ne vartesi agjenci bankare dhe zyra bankare.

### Neni 56.

#### Drejtimi i deges se bankes

Drejtimi dhe administrimi i deges se Bankes ushtrohet nga drejtori i saj, i cili pergjigjet per gjithe veprimtarine e deges ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi qe veprojne ne fushen bankare, udhezimet e Drejtorise se Pergjithshme dhe dispozitat te ketij statuti.

Drejtori i deges se bankes ne perputhje me strukturen organizative dhe numrin e punonjesve te miratuar, emerone e shkarkon punonjesit dhe percakton pagat e tyre mujore, ne perputhje me tabelen e pagave te miratuar nga Keshilli Drejtues.

### Neni 57

#### Raportimet e deges se bankes

Dega e Bankes i dergon Drejtorise se Pergjithshme, ne afatet e caktuara prej saj, bilancin me relacionin shoqerues dhe evidencat e tjera statistikore, si dhe çdo informacion tjeter qe i kerkohet.

## **KAPITULLI VII**

### **KUJDESTARI DHE LIKUIDIMI**

Neni 58.

#### Dispozitat e zbatueshme

Per kujdestarine si dhe per likuidimin e bankes ne rast prishjeje ose falimentimi zbatohen dispozitat e ligjit "Per sistemin bankar ne Republiken e Shqiperise" si dhe te ligjeve te tjera qe rregullojne keto gjendje.

## **KAPITULLI VIII**

### **DISPOZITA TE PERKOHESHME**

Neni 59.

#### Aksioneri i vetem

Sa kohe qe banka do te jete me kapital teresisht shteteror aksioneri i vetem i saj do te jete Ministri i Financave.

Ministri i Financave, me cilesine e tij si aksioner i vetem i bankes do te kete te gjitha atributet dhe do te ushtroje te gjitha kompetencat qe ligji dhe ky statut ia ka njohur shprehimisht mbledhjes se pergjithshme te aksionereve.

AKTIV

31.12.1999

31.12.1998

MONETA MONETARE

893.287.860,15

1.784.801.511,70

Neni 60.

Cfuqizimi i dispozitave te perkoheshme

Privatizimi i bankes ne çfaredo perqindje te kapitalit shteteror edhe neqoftese shteti do te vazhdoje te mbetet aksioner i ben te pavlefshem nenin 59.

**AKSIONERI**

**MINISTRI I FINANCAVE**

**ARBEN MALAJ**



*Handwritten signature of Arben Malaj*

II. LLOGARI E DEPOZITAVE

7.181.855.929,70

3.242.074.982,00

- 1. Llogari shprehese ne lek
- 2. Depozita shprehese bankare
- 3. Te tjera

III. LLOGARI E DEPOZITAVE

1.100.000,00

1.100.000,00

- 1. Llogari shprehese ne lek
- 2. Llogari shprehese ne valute
- 3. Depozita me afat ne banka
- 4. Kredi papag. per munitet
- 5. Kredi ne lek

V. KREDI BANKARE

1.100.000,00

1.100.000,00

- 1. Kredi afatshomer
  - a) Kredi per biznes
  - b) Kredi per ndihmet
  - c) Kredi per papag. privat
  - d) Kredi papag. ndiprivat
  - e) Kredi papag. ne papag. ndiprivat
  - f) Kredi te tjera te papag. ndiprivat
  - g) Kredi te tjera te papag. ndiprivat
- 2. Kredi shtriguate
  - a) Kredi shtriguate
  - b) Kredi ndiprivat
  - c) Kredi per banese ne vler
  - d) Kredi per banese ne te m
  - e) Kredi e papag. ndiprivat
  - f) Kredi e papag. ndiprivat

118.028.572,25  
28.071.692,25  
0,00  
14.210,00  
0,00  
31.414.587,00  
0,00  
7.775.700,00  
1.211.497.042,90  
570.504.799,00  
163.440.722,00  
383.085.421,90  
0,00  
244.576,00

118.028.572,25  
77.025.164,60  
0,00  
13.481.303,00  
0,00  
24.740.572,00  
0,00  
0,00  
1.245.303.378,60  
1.012.541.140,60  
42.886.837,00  
767.171.447,70  
0,00  
544.758,00